

**Ali Aliu** është akademik, shkrimtar, eseist, kritik letrar dhe përkthyes shqiptar nga Maqedonia.

Ali Aliu lindi më 1 prill 1934 në Prespë (Kranjë). Shkollën fillore tetëvjeçare e kreu në qytetin e Manastirit në vitin 1951, ndërsa Shkollën Normale në Shkup, më 1955. Studimet universitare (albanologji) i mbaroi në Universitetin e Beogradit në vitin 1960. Doktoroi në Universitetin e Prishtinës më 1973. Pas studimeve zë punë gazetar në redaksinë “Flaka e vllaznimit” në Shkup, ku punoi dhjetë vjet. Prej vitit 1969 deri në vitin 1972 punoi redaktor në Edicionin e Botimeve “Rilindja” në Prishtinë. Që nga viti 1972 deri në pensionim ishte ligjërues në Fakultetin Filozofik, përkatësisht në Fakultetin e Filologjisë të Prishtinës ku ka ligjëruar lëndën *Teori e letërsisë*. Në vitin 1996 u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ndërsa në vitin 2000 anëtar i rregullt i saj. Është studiues i letërsisë bashkëkohore shqiptare, fushë nga e cila ka botuar shumë vepra. Ka drejtuar disa kandidatë në tema të magistraturave dhe doktorateve. Ishte njëri nga themeluesit e LDK-së në vitin 1989 dhe anëtar i Kryesisë së saj në dy mandate, deri në vitin 1995. Ka drejtuar zyrën e Kosovës në Tiranë (1991). Aktualisht ligjëron në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë.

#### Tituj të veprave

- *Kërkime, Rilindja, Prishtinë, 1971.*
- *Shqyrtime, Rilindja, Prishtinë, 1974.*
- *Rrjedhave të letërsisë, Rilindja, Prishtinë, 1977.*
- *Katër romane të Petro Markos, Flaka e vllaznimit, Shkup, 1974.*
- *Kritika, Rilindja, Prishtinë, 1980.*
- *Artikuj kritikë, Rilindja, Prishtinë, 1983.*
- *Ese letrare, Rilindja, Prishtinë, 1987.*
- *Kërkime, Naim Frashëri, Tiranë, 1990.*
- *Don Kishoti te shqiptarët, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1996*
- *Reflekse letrare, Flaka, Shkup, 1999.*
- *Antologji e poezisë shqipe, Klubi letrar, Tetovë, 1999.*
- *Antologji e poezisë shqipe, Albin, Tiranë, 2002.*
- *Teoria e letërsisë, Enti i Teksteve Shkollore, Prishtinë, 1985.*
- *Teori e letërsisë, (ribotim i plotësuar) Enti Shkollor, 2001 dhe Vatra, Shkup, 2002.*
- *Antologji e poezisë shqipe, Klubi letrar - 94, Tetovë, 2000*
- *Antologji e poezisë shqipe, (ribotim i plotësuar), Albin, Tiranë, 2002*
- *Antologjia na albanskata poezija (maqedonisht), Pro Littera, Shkup, 2004*
- *Letërsia bashkëkohore shqiptare, koautor, për klasat e katërta të shkollave të mesme) Alb-ass, Tiranë - Tetovë, 2001; Libri Shkollor, Prishtinë më 2002.*
- *Letërsi, koautor, për klasat e para të shkollave të mesme, Alb-ass Tiranë-Tetovë,*
- *Kush do ta vrasë ujkun, tekst plus për maturantët: zgjedhje dhe analizë e poezisë së Ali Podrimjes, Alb-ass Tiranë, Tetovë dhe Libri Shkollor, Prishtinë, 2002,*
- *Si ta lexojmë poezinë?, Alb-ass, Tetovë-Tiranë, 2004.*
- *Magjia e fjalës, Dukagjini, Pejë, 2003.*

- *Kronika letrare*, Logos, Shkup, 2003.
- *VEPRA TË ZGJEDHURA, I, II, III, IV*, Serembe, Shkup, 2004.
- *Don Kishoti shqiptar*, ASHAK, Prishtinë, 2005.
- *Miti ballkanik te Kadareja*, Onufri, Tiranë, 2007.
- *Fjalë për fjalën*, Serembe, Shkup, 2008
- *Dëshmi letrare*, ASHAK, Prishtinë, 2008.
- *Shtegtimi i metaforës*, Toena, Tiranë, 2009.
- *Don Kishoti shqiptar*, Toena, Tiranë 2010.
- *Kënaqësia e leximit*, ASHAK, Prishtinë, 2012.
- *Azem Shkreli – lirika që la gjurmë të një epoke*, studim monografik, Agora, Tiranë, 2019.
- *Dritëro Agolli – poeti lirik dhe prozatori i sfidave*, studim monografik, Agora, Tiranë, 2019.
- *Fatos Arapi- poezia lirike që vendosi standard*, studim monografik, Agora, Tiranë, 2019.
- *Kadare mund titanët e letërsisë*, studim monografik, Agora, Tiranë, 2019.
- *Kim Mehmeti dhe imagjinata kreative*, studim monografik, Agora, Tiranë, 2019.
- *Majlinda Nana Rama dhe universaliteti krijues i saj*, studim monografik, Agora, Tiranë, 2019.
- *Zija Çela dhe tërmetet narrative*, studim monografik, Agora, Tiranë, 2019.
- *Lirika dhe tradita letrare, Studim, Agora Tiranë, 2019*
- *Një lexim i poezisë, Agora, Tiranë, 2022.*

Në gjuhë të tjera:

Maqedonisht:

- Don Kihotot medju albancite, *Kultura, Skopje, 2004.*
- Skenderbeg (*bashkë me Gane Todorovskin*), *ASHAM, Shkup, 2005.*

Bullgarisht:

- Don Kihotot meždu albancite, *Blgarski pisatel, Sofija, 2008.*

Anglisht:

- Don Quixote among Albanians, *St. Clement of Ohrid, National and University Library, Skopje, 2011.*

**Vlerësimet**

- Nderi i Kombit dorëzuar nga presidenti Bujar Nishani
- Medalja e Artë e Lidhjes së Prizrenit
- Penda e Artë nga Ministria e Kulturës, Tiranë
- Çmimi shtetëror "11 Tetori", Maqedoni

- Çmimi kritik 'Dimitar Mitrev', Maqedoni
- Çmimi 'Azem Shkreli' për vepër jetësore nga Ministria e Kulturës, Kosovë
- Çmimi i Madh Kombëtar 'Harpa 2015'
- Çmimi 'Poeteka'